



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 202/h Prot.

Vlorë më, 24.12. 2021

VENDIM
Nr. 52, datë 22.12.2021

PËR
MIRATIMIN E EKOMANDIMEVE NË KUADËR TË PROJEKTIT SUCCESS

Në mbështetje të nenit nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar shkresës nr.1967 prot, datë 20.12.2021 të Kordinatorit të Projektit SUCCESS, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.12.2021

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin në kuadër të projektit SUCCESS, të objektivave afatgjatë, rekomandimeve, që vijnë si detyrim nga paketa e parë e punës për këtë projekt, të aktiviteteve si më poshtë:
 - a) Ftesë drejtuesve të biznesit dhe ish-studentëve që të mbajnë leksione në fakultet
 - b) Modernizim i kurrikulës- duke përfshirë raste studimi, simulime, leksione nga përfaqësues të biznesit.
 - c) Nxitja e programeve të shkëmbimit global- rekomandohen programet e shkëmbimit të të rinjve
 - d) Promovimi i rezultateve të studentëve, studentët më të mirë, etj – përdorimi i faqes web për të promovuar rezultatet e studentëve, promovimi i studentëve më të mirë në ceremonitë e diplomimit, etj
 - e) Lidhja e kurrikulës me sfidat e botës reale- rishikimi i rregullt i kurrikulës.
2. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Kordinatorit të projektit SUCCESS.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola AGARAJ

